



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 373/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha, Kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Hoxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruara nga kandidatët për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Fadil Aliu, Muhamet Mustafa, Nuredin Ibishi dhe Besnik Krasniqi, të gjithë nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat Anr.373/2017, Anr.374/2017, Anr.375/2017, Anr.376/2017 të parashtruara me datë 30.06.2017 nga Fadil Aliu, Muhamet Mustafa, Nuredin Ibishi dhe Besnik Krasniqi, të gjithë nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr. 373/2017, 374/2017, 375/2017 dhe 376/2017 me datën 30.06.2017 në ora 11:30, nga parashtruesit e ankesave Fadil Aliu, Muhamet Mustafa, Nuredin Ibishi dhe Besnik Krasniqi, të gjithë nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Prishtinë .

Në ankesat e parashtruara ankuesit pretendojnë se me vendimin mbi shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 29.06.2017 ju janë shkelur të drejtat ligjore gjatë procesit zgjedhor të 11 qershorit 2017, përmes manipulimit të votave gjatë numërimit, prandaj kanë kërkuar rinumërimin e pjesshëm të vendvotimeve VV sipas metodave të pranuar shkencore.

Në ankesë ankuesit kanë kërkuar që konform nenit 120 i LZP-së të bëhet rinumërimi i përgjithshëm ose i pjesshëm i vendvotimeve VV, në disa vendvotime dhe të veprohet në përputhje me ligjin kundër kryesve të veprave penale.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 373/2017, për shkak të natyrës së njejtë të rasteve dhe pretendimeve, ankesën Anr 374/2017, Anr. 375/2017 dhe Anr 376/2017 vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesat janë të pabazuara**

PZAP-i, konstatoi se ankuesit në ankesat e tyre kërkojnë që të rinumërohen pjesërisht kutit e votimeve sipas metodës së pranuar - Metodës së Mostrës së Rastit, me pretendim se me vendimin mbi shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 29.06.2017 ju janë shkelur të drejtat ligjore gjatë procesit zgjedhor të 11 qershorit 2017, përmes manipulimit të votave.

Paneli pa vlerësimin të pretendimeve ankimore të ankuesve gjeti se ankuesit me asnjë provë bindëse nuk kanë dëshmuar se në cilin vendvotim VV iu janë bërë parregullsitë e pretenduara. Prandaj Paneli ankesat e ankuesve i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tulla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuara ngase në ankesat e tyre nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesit e ankesave. Po ashtu nuk kanë dhënë asnjë udhëzim apo hollësi në mbështetje të pretendimeve në ankesa. Ndërsa, provat e parashtruara në ankesat sipas vlerësimit të Panelit nuk paraqesin referencë ligjore në mbështetje të pretendimeve në ankesa e as bazë të vlefshme ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për ankuesve.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe e të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat e ankuesve e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.373/2017 më datën 02.07.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Ymer Hoxha



### **Udhëzim Juridike:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*